

KARTELE INFORMATIVE

AL019002

1. Emri i shërbimit	Kërkesë për shtrirjes të aplikimit për Patentë Evropiane			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Çdo person që ka një aplikim për patentë evropiane, të dhënë në bazë të këtij aplikimi nga Organizata Evropiane e Patentave, sipas Konventës Evropiane të Patentave, mund të kërkojë shtrirjen e mbrojtjes në Shqipëri me kërkesë të aplikantit. Kërkesa për shtrirje vlerësohet se është depozituar në çdo aplikim për patentë evropiane të depozituar, në ose pas datës kur marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Evropiane të Patentave ka hyrë në fuqi.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Një aplikim për patentë evropiane që shtrihet në Republikën e Shqipërisë në përputhje me dispozitat ligjore, ka të njëjtin efekt dhe u nënshtrohet të njëjtave kërkesa si aplikimi për patentë kombëtare, të përcaktuara në ligj.			
4. A jam përfutues?	Individ, Person fizik apo juridik, biznes, OJF, Institucion, Universitet, Qendra Kërkimore dhe kushdo që ka bërë një shpikje.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formulari i Kërkesës për shtrirje të aplikimit për Patentë Evropiane	Aplikanti / Institucioni	Po
	2	Pershkrimi i shpikjes	Aplikanti	Po
	3	Përkthimi në shqip i pretendimeve të patentës evropiane. Kur pretendimi përmban shenja referencë të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit	Aplikanti	Po
	4	Dokumenti i pagesës së tarifës së aplikimit	Banka	Po
	5	Autorizimi i përfaqësimit	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	E hënë - e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	☐	☒	☐	☐
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë 1 000 lekë	Tarifa shtesë Komisioni bankar	Tarifa Online	Mënyra e pagesës Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	3 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit			
10. Çfarë përfitoj?	Njoftim			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	20 vjet			
12. Ku e marr?	Në sportele ☒	Me postë ☐	E-albania ☐	Me e-mail ☐
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktto në: E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Orari Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele ☒	Me postë ☐	Web-i i Institucionit ☐	Me e-mail ☐
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		☒	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; Ligji Nr. 10180, datë 29.10.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale"; VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores "Për lëshimin e patentave për shpikje dhe modelet e përdorimit", e ndryshuar; VKM Nr. 883, datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar.			